



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Primijeno/Prodato Received/Delivered	30.05.2023	viti god year	
Organ/Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPN/HM	4515/2023		1/5



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

**A.nr.718/2023**

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.718/2023 të datës 11.05.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër Njoftimit të datës 04.05.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 30.05.2023, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

**Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.718/2023 e datës 11.05.2023, e parashtruar nga ankuesja**

**A r s y e t i m**

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 14.03.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me numër Reference RN00011216 për pozitën *Sekretar i Përgjithshëm 1* për Ministrinë e Mbrojtjes, ku është përcaktuar afati për aplikim nga data 13.04.2023 deri më datë 20.04.2023. Në këtë konkurs kanë aplikuar nëntë (9) kandidatë në mesin e tyre dhe ankuesja, ndërsa pas verifikimit paraprak të datës 27.04.2023 vetëm dy (2) kandidatë kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak.

Më datë 27.04.2023 ankuesja përmes emailit është njoftuar nga Zyrtar për Zhvillimin e Konkurrimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë se i është refuzuar

aplikacioni për shkak se i mungon dëshmia e përvojës së punës prej pesë (5) vitesh në pozita drejtuese. Më datë 27.04.2023 ankuesja përmes emailit ka kërkuar që të shqyrtohet në mënyrë të drejtë aplikacioni për shkak që nuk është shqyrtuar e gjithë dokumentacioni i dërguar që ndërlidhet me përvojën e punës, ndërsa më datë 04.05.2023 përmes emailit ankuesja është njoftuar nga Udhëheqësja e Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit se është verifikuar përsëri aplikacioni dhe është konstatuar se nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme të përvojës së punës në pozita drejtuese së paku pesë (5) vite ashtu siç është kërkuar në konkurs.

Ankuesja, kundër këtij njoftimi, me datë 11.05.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 4178/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 17.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli më datë 26.05.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoli 4178/2023 të datës 11.05.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emetimin e darës 15.07.2011; Vërtetimin e datës 19.01.2023; Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 16.08.2005 deri 14.04.2023; Letër vërtetimi nga ABA/CEELL; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 17.05.2023; Përgjigje në ankesë të datës 26.05.2023; Konkursin me numër Reference RN00011216 për pozitën *Sekretar i Përgjithshëm 1* për Ministrinë e Mbrojtjes të datës 14.03.2023 të shpallur nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Lista e aplikantëve; Lista e aplikantëve të refuzuar dhe aprovuar; Njoftimin i datës 27.04.2023 për listë të ngushtë; Njoftimin përmes emailit i datës 27.04.2023 për ankuesen për refuzim të aplikacionit; Emailin e datës 27.04.2023 nga ankuesja për Sh.H për rishqyrtim të aplikacionit; Njoftimin përmes emailit i datës 04.05.2023 për ankuesin lidhur me shqyrtimin e kërkesës për refuzim të aplikacionit; Aplikacionin e ankueses të datës 19.04.2023; Letër motivuese e ankueses; Diplomë me Nr. 398; Diplomë me Nr. 02-611-427/81; Letër vërtetimi i datës 25.05.2015 nga OSCE; Certifikatën mbi dënimet penale e datës 03.04.2023; Dokument identifikimi për ankuesen; Njoftim për masë disiplinore; Njoftim nga ankuese për vlerësim të rezultateve në punë; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e lidhur me datë 22.10.2022; Vërtetimin e datës 27.04.2000; Shkresën nga UNDP e datës 13.07.2022; Aktvendim i datës 10.07.2007 i Kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë; Certifikatën e datës 22.06.2018; Certifikatën 15-18.09.2014; Certifikatën 28/29.01.2014; Certifikatën 26-29.10.2009; Certifikatën 02-05.09.2008; Diplomë për periudhën 06.10-06.12.2008; Certifikatën e datës 22.07.2002; Certifikatën e datës 21.03.1997; Certifikatën tetor-dhjetor 2017; Certifikatën 22-24.04.2013; Certifikatën për periudhën 29.10.2012 deri 02.11.2012; Certifikatën tetor 2011; Certifikatën shtator 2011.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesja, është e *pa bazuar, sepse:*

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër refuzimit të aplikacionit nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/Ministri e Punëve të Brendshme për pozitën Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes, pretendon se ka ofruar dëshmi të mjaftueshme më të cilat vërtetohet se përvoja e punës në pozita drejtuese për së paku 5 vite.

Bazuar në konkursin me numër Reference RN00011216 për pozitën *Sekretar i Përgjithshëm 1* për Ministrinë e Mbrojtjes të shpallur më datë 14.03.2023 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, kërkesat e përgjithshëm formale kanë qenë:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit ë lartë me së paku 4 vite të studimeve. E preferuar në fushat që ndërlidhen më fushëveprimtarin e institucionit ku rekrutohet.*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku (8) vite përvojë pune profesionale,, duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese.*

Ankuesja me rastin e dorëzimit të aplikacionit për pozitën e cekur si më lartë në kuadër të dëshmive të përgatitjes profesionale (arsimimit të kërkuar) dhe përvojës së punës ka dorëzuar dokumentet si: Diplomën Nr. 398 të datës 10.05.2004 të lëshuar nga Fakulteti Filozofik, dega Gjuhe dhe Letërsie Angleze, dëshmohet se më datë 28.02.1998 ka mbaruar studimet themelore duke marr titullin "Profesor", sa i përket dëshmive të përvojës së punës e njëjta ka dorëzuar, Vërtetimin e datës 27.04.2000 të lëshuar nga KMDLNJ, me të cilën dëshmohet se ka punuar në bazë vullnetare nga muaj dhjetor i vitit 1994 deri në muajin nëntor të vitit 1998, Letër vërtetimin e lëshuar nga ABA CEELL ku ka punuar nga muaji prill 2005 deri në muajin nëntor 2006 (14 muaj kumulativ) si Menaxhere ne Terren, Vërtetimin e lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes së datës 19.01.2023 m të cilën konstatohet se ka qenë në marrëdhënie pune në këtë ministri nga data 15.07.2011 deri më datë 24.03.2016, dhe Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 16.08.2005 deri 14.04.2023.

Kolegji i Këshillit bazuar në dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, përkatësisht nenin 7 paragrafi 3 përcakton që: "3. Së bashku me aplikacionin për konkurrim, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin plotësues në vijim: 3.1. kopjet e diplomave mbi kualifikimin arsimor, kurse për diplomat e marra jashtë vendit, nevojitet nostrifikimi; 3.2. kopjet e dëshmisë së punësimit që përfshin pozitën dhe datat e mbajtjes së pozitës; 3.3. kopjet e dokumenteve që dëshmojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurimit dhe të deklaruara në aplikacion", si rrjedhojë edhe pse ankuesja me rastin e aplikimit ka dorëzuar Akt Emërimit e datës 15.07.2011 për pozitën Shef i Sektorit të Verifikimit të lëshuar nga Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe e cila në aplikacionin e saj deklaroi që këtë pozitë e ka mbajtur

nga data 15.07.2011 deri më datë 24.03.2016, në bazë të Vërtetimit të datës 19.01.2023 të lëshuar nga Departamenti për Politika të Personelit dhe Rekrutimit të Ministrisë së Mbrojtje përshkruhet faktin se ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune në këtë ministri sipas Akt Emërimit nga data 15.07.2011 deri më datë 24.03.2016, nuk përcaktohet saktë pozita që ka mbajtur përgjatë këtyre viteve. Po ashtu në bazë të Letër Vërtetimit të lëshuar nga ABA CEELL, përshkruhet se ku ka punuar nga muaji prill 2005 deri në muajin nëntor 2006 (14 muaj kumulativ) si Menaxhere ne Terren, mirëpo nuk është e përshkruar në mënyrë të saktë se pozita që ka mbajtur ankuesja në këtë rast është pozitë menaxheriale (drejtuese), ndërsa në bazë të Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 16.08.2005 deri 14.04.2023, mund të konstatohet se ankuesja marrëdhënien e punës në ABA CEELL e ka të paguar për periudhën shtator dhe dhjetor 2005, mars, qershor, shtator dhe dhjetor 2006.

Marr parasysh provat e lëndës të dërguara nga ankuesja si dhe referuara dispozitave ligjore të cekura si më lartë, Kolegji i Këshillit, vlerëson se ankuesja nuk ka arritur të dëshmoj me prova materiale që pozitat që ka mbajtur sipas vërtetimeve të cekura si më lartë e që pretendon se ka më shumë se pesë (5) vite në pozita drejtues, janë pozita të kategorisë drejtuese, rrjedhimisht e njëjta nuk ka dëshmuar që ka plotësuar kushtet e konkursit sa i përket përvojës së punës prej pesë (5) vitesh në pozita drejtuese, kusht ky i përcaktuar me kriteret e konkursit po ashtu edhe me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil konkretisht me shtojcën Nr. 1/1 që ndërlidhet me përshkrimi e përgjithshëm të punës për klasën Drejtues i Lartë 1 me pikën IV tek shkronja c.

Bazuar në këtë Kolegji i Këshillit, konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me rastin e verifikimit paraprak për rastin e ankueses, ka vepruar në bazë të kompetencave të saj të përcaktuara me nenin 40 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me nenin 8 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, i cili përcakton se: *"2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikacionit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë konkurrimin në fazën e vlerësimit profesional"* si dhe në bazë të kriterëve të përcaktuar me dispozitat ligjore në fuqi dhe kriteret e konkursit, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.718/2022, datë 30/05/2023

**Avdyl BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Arben MEHMETI**

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses,
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.